



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV-të
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 140/14
Prishtinë, më 22.01.2014, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Muhamet Musafa, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Sevdije Lama.

Mungoi: Hykmete Bajrami.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: zv. Ministri i Financave – Naim Fetahu, Enis Spahiu dhe Qerkin Berisha nga Ministria e Financave, gazetar të RTV21 dhe KosovaPress, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KfW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSST, për përmirësimin e rrjetit të transmisionit;**
4. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-243 për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-197 për Kemikate me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
6. **Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Legjislacion për vlerësimin e kostos financiare të Projektligjit për deputetë;**
7. **Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2013;**
8. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit

Kryetarja konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt.27.11.2013, 04.12.2013, 09.12.2013, 10.12.2013, 12.12.2013 dhe 18.12.2013, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KfE Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSST, për përmirësimin e rrjetit të transmisionit

Kryetarja thekson se Qeveria e Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave si Huamarrësi dhe operatori i sistemit transmisionit dhe tregut KOSTT - Agjencia për ekzekutimin e projektit ka nën shkruar marrëveshje për hua me KfW me vlerë prej 23,500,000 euro për përmirësimin e rrjetit të transmisionit.

Naim Fetahu sqaroi se në kuadër të bashkpunimit ekonomik të Kosovës dhe Gjermanisë, sipas marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit, për çdo vit sipas negociatave ndërqeveritare nënshkruajm protokollin ku përcaktohen fushat konkrete të bashkëpunimit. Në marrëveshjen që po diskutohet, Qeveria e Kosovës do ti huazoj nga KfW 23.500,000 milion euro dhe do ti pranojë nga Komisioni Evropian 3 milion euro Kontributë Financiar. Këto mjetet janë të dedikuara për KOSTT që realisht është edhe përfituesi i mjeteve. Ndermarja Publike KOSST është ndërmarje e cila realizon kthim pozitiv, por që ka nevojë për investime në infrastrukturë, për të akomoduar nevojat zhvillimore.

Naser Osmani u interesua të dinte për funksionimin e KOSST. Nëse kemi të bëjmë me një korporatë, si funksionon financimi brenda Korporatës, sepse ne kemi dhënë para të mëdha për këtë korporatë. A ka mundësi ata si korporatë me marrë kredi dhe vetë ti kthejnë ato mjete apo shteti shteti të hynë në kredi për me i mbulue investimet e tyre?

Qerkin Berisha sqaron se kemi të bëjmë me një marrëveshje për nën huazim, që do të thotë se pagesën e Kësteve të Kredisë por edhe interesin nuk e bënë Qeveria e Kosovës dhe nuk ka ndonjë implikim financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës është ndërmjetësuese e kredisë pasi që, pasi që KOSST nuk ka drejtë me hyjë në këso llojë kredije, por se përfituese dhe obliguese e kësaj kredie është ndërmarja publike KOSTT.

Naser Osmani pyeti cilat janë burimet e të hyrat të KOSTT-it?

Qerkin Berisha njoftoi se burimet e të hyrave të KOSTT-it janë nga transmisioni i energjisë elektrike qoftë i brendshëm apo ndërkombëtar dhe ka një kthim pozitiv në të hyrat në qarkullim dhe KOSTT, deri më tani i ka paguar Qeverisë së Kosovës edhe dividend.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni me shtatë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Sevdije Lama), një Abstenim (Naser Osmani) dhe asnjë Kundër, nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KfW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSST, për përmirësimin e rrjetit të transmisionit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-243 për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës

Kryetarja theksoi se qëllimi kryesor i këtij PL është themelimi i Inspektoriatit të Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës në kuadër të ministrisë finanacave si dhe procedurat që do të zhvillohen gjatë zhvillimit të hetimeve dhe inspektimeve. Në këtë PL është përcaktuar edhe roli i ministrisë së finanacave me raport me inspektoratin dhe qëllimi është që të kontribuojë në luftimin e dukurive negative, siç janë luftimi i ekonomisë joformale, luftimi i konfliktit të interesit, ngritja e performances së doganës dhe administratës tatimore. PL si i till përmban memorandumun që shpjegon synon që duhet ti pëmbaj projektligji, deklaratën për ndikimin buxhetor, deklaratën për përafrimin e legjislacionit me atë të bashkësisë evropiane dhe si ti tillë i përmbush kushtet formale juridike për miratim në parim.

Naim Fetahu sqaroi se ky PL përcakton veprimet edhe parimet e këtij inspektoratit të doganës dhe administratës tatimore, rregullon statusin e tij, përcakton rolin e ministrisë së finanacave në raport me inspektoratin, mënyrë e organizimit dhe funksionimin e inspektoratit etj. Në aspektin hetimor ky PL përcakton kompetencat hetimore dhe inspektuese të inspektoratit të doganës dhe ATK-së si dhe procedurat të cilat respektohen gjatë zhvillimit të hetimeve dhe inspektimeve. Vlenë të theksohet se gjatë hartimit të këtij PL, ministria e finanacave ka analizuar praktika më të mirat të vendeve evropiane. PL po ashtu drejtpërdrejt dhe tërthorazi do të ndihmojë në rritjen e të hyrave të doganave dhe të administratës tatimore rritjen e performances së këtyre institucioneve në zbatimin e ligjit për luftimin e ekonomisë joformale, në luftimin e konfliktit të interesit, në rritjen e sigurisë juridike, rritjen e nivelit të transparencës dhe në luftimin e të gjitha formave tjera të korrupsionit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.04/L-243 për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-197 për Kemikate me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja theksoi se nëse e shohim deklaratën financiare të këtij projektligji, vërejmë se nuk ka implikime të mëdha buxhetore e të papërbalueshme për buxhetin e Kosovës. Po ashtu edhe amendamentet e komisionit funksional nuk mbajnë implikime buxhetore .

Naser Osmani theksoi se është një qështje në amendamentin 34, pika 1.21 meriton vëmendje, ku janë paraparë denimet prej 5,000 deri në 10,000 euro, nëse personi zhvillon testimet me njerzë. Pra po flitet për testimet me njerzë me kemikale që është një përgjegjësi e madhe dhe të parashihen këto lloje denime është e papranueshme. Te tesimi me njerzë ka tjera masa ndëshkuese të përcaktuara me kodin penal.

Kryetarja sqaroi se kjo është një qështje që bie në kompetencën e komisionit për legjislacion dhe qështja e dënimeve është e rregulluar me ligjin penal të Kosovës.

Naser Osmani po flasim për gjoba dhe ndoshta mund të japim vërejtje që pika 1.12 të rishikohet dhe rregullohet ndryshe.

Latif Gashi theskoi se qështje e denimeve është e rregulluar me kodin penal dhe unë mendojë që kjo siç është propozuar ka të bëjë me denimet materiale që mund të jenë denime shtesë, përveq atyre që janë paraparë me kodin penal. Ne nuk jemi komision përgjegjës me intervenue në këtë pjesë.

Albana Fetoshi theksoi se këtu thuhet se nenin 29 paragrafi 3 e ndalon këtë, kurse në nenin tjetër thuhet se duhet të gjobitet. Nëse me një nen ndalohet atëherë kjo duhet të vlejë edhe për nenin tjetër.

Kryetarja si komision për buxhet dhe financa, jemi përgjegjës, të shqyrtojmë koston buxhetore të projektligjit dhe ndikimin e tij për buxhetin e republikës së kososvës. Kuptohet se edhe këto denime hyjnë në qështje që është shumë e rëndësishme, por rasti në fjalë që u diskutua është qështje e komisionit për legjislacion, i cili duhet ta harmonizojë dhe me kodin penal.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Projektligji nr.04/L-197 për Kemikate dhe amendamentet e Komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Legjislacion për vlerësimin e koston financiare të Projektligjit për deputetë

Kryetarja sqaroi se komisioni për legjislacion si hartues i Projektligjit për deputetët ka kërkuar nga komisioni për buxhet dhe financa të bëjë vlerësimin e koston financiare të këtij projektligji. Duke pas parasysh faktin se hartuesi i PL është komisioni për legjislacion si komision funksional është detyrë e këtij komisioni me bashkëpunim me drejtorinë për buxhet dhe pages të administratës së kuvendit të bëjë vlerësimin fillestar të ndikimit buxhetor dhe t’ia bashkangjes projektligjit deklaratën për ndikimin buxhetor. Komisioni për buxhet dhe financa, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, shyrton projektligjet në bazë të vendimit të kuvendit, i cili i ngarkon komisionet e përhershëm pas miratimit në parim të PL, të shyrtojnë dhe më pas të raportojnë për projektligjet sipas kompetencës dhe në pajtim me nenin 57 të rregullores. Pra, Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk është kompetent të shqyrtojë në këtë fazë projektligjin, dhe propozojë që të nxjerrim në Përfundim për komisionin për legjislacion, që ky komision të kërkojë nga drejtori për buxhet dhe pagesa e administratës së Kuvendit të hartojnë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe t’ia bashkangjesin projektligjit. Komisioni për Buxhet dhe Financa, do ta shqyrtojë projektligjin, pasi që ti bashkangjitet deklarata e ndikimit buxhetor dhe në pajtim me nenin 57 të Rregullores së Kuvendit.

Pas sqarimeve dhe propozimeve, Komisioni nxorri këtë

Përfundim

1. Komisioni për Legjislacion si propozues i Projektligjit për deputetë të kërkojë nga Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa e Administratës së Kuvendit, të hartojë Deklaratën financiare për ndikimin buxhetor të Projektligjit.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, shqyrton projektligjet të cilat e kanë të bashkangjitur deklaratën e ndikimit buxhetor dhe në bazë të nenit 57 të Rregullores së Kuvendit, raporton lidhur implikimet buxhetore të projektligjit.

7. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2013

Kryetarja theksoi se nga raporti shofim se komisioni në vitin e kaluar ka bërë një punë intensive. Në raport janë prezantuar aktivitetet më të rëndësishme që ka zhvilluar komisioni. Shofim se vitin e kaluar kemi mbajtur 53 mbledhje, është hartuar një projektligj, kemi shqyrtuar dhe rekomanduar për 9 PL për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Si komision i përhershëm kemi shqyrtuar 48 projektligje. Janë caktuar 19 grupe punuese që kanë mbajtur 56 takime, ndërsa si komision funksional kemi propozuar 182 amendamente. Në raport janë të përfshira edhe takimet e përbashkëta me komisionet tjera, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, vizitat jashtë vendit dhe aktivitetet tjera.

Pas sqarimeve, Komisioni njëzëri miratojë Raportin vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2013.

8. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi se në një takim që do të mbahet me 20-21 shkurt 2014 në Prishtinë në kuadër të dialogut për asocim-stabilizim me përfaqësues vendor dhe të Komisioni Evropian, jam e ftuar të marr pjesë në cilësinë e kryetarës së komisionit, dhe me datën 20 shkurt në agjendë është paraparë që kryetarja e komisionit për buxhet dhe financa dhe kryetari i komisionit për arsim, kulturë, rini, sport, qeverisje lokale, administratë publike dhe media, të diskutojnë lidhur me qështjen e financimit të transmetuesit publik-RTK-së. Unë në këtë datë nuk mund të marrë pjesë dhe propozoj që komisionin për buxhet dhe financa në këtë takim, ta përfaqësoj zëvendës kryetari i parë i komisionit, z. Naser Osmani. Në rast se ai nuk mund të marrë pjesë, atëherë komisionin e përfaqëson zëvendës kryetarja e dytë, znj. Jelena Bontic.

Si përfundim, Komisioni njëzëri vendosi që në takimin e datës 20 shkurt 2014, që do të mbahet në Prishtinë në kuadër të dialogut për asocim-stabilizim me përfaqësues vendor dhe të Komisioni Evropian, Komisionin për Buxhet dhe Financa, ta përfaqësojë zëvendës kryetari i parë i komisionit, z. Naser Osmani. Në rast se ai nuk mund të marrë pjesë, atëherë komisionin e përfaqëson zëvendës kryetarja e dytë, znj. Jelena Bontic.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj